

RAPORTI I VLERËSIMIT TË QASSHMËRISË SË NDËRTESAVE SHKOLLORE TË NIVELIT FILLOR DHE MESEM TË ULËT PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOSOVË





Ky publikim është botuar me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e HANDIKOS-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqesë pikëpamjet e UNICEF-it.

**Autorë: Rozafa Basha, arkitekte &
HANDIKOS**

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	5
Hyrja	7
Konteksti i studimit	7
Qëllimi dhe objektivat e studimit	9
Metodologjia	10
Parametrat kryesorë të qasjes në ndërtesat shkollore të vlerësuara	12
Të gjeturat në nivel regjional	16
Regjioni i Prishtinës	17
Regjioni i Gjakovës	19
Regjioni i Pejës	20
Regjioni i Ferizajt	22
Regjioni i Mitrovicës	23
Regjioni i Prizrenit	25
Regjioni i Gjilanit	26
Limitet e raportit	28
Konkluzionet	29
Rekomandimet	30
Shtojca 1. Lista e shkollave të vlerësuara	33
Shtojca 2. Lista e hulumtuesve të terrenit	36
Shtojca 3. Fotografi të rasteve ideale të qasjes në shkolla	37
Shtojca 4. Fotografi të problematikave të identifikuar në terren	40
Shtojca 5. Literatura	43

LISTA E SHKURTESAVE

BE – Bashkimi Evropian

MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

PAK – Persona me Aftësi të Kufizuara

OZHQ – Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

SHFMU – Shkollë fillore dhe e mesme e ulët

U.A. – Udhëzim Administrativ

UNICEF – Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencat e Fëmijëve

KDF – Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KKBDPAK – Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

FJALA HYRËSE

Vlerësimet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë tregojnë se personat me aftësi të kufizuara përbëjnë rreth 15 % të popullatës së përgjithshme. Duke u bazuar në këto vlerësime, del se 77.730 persona nga numri total i regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, janë persona me aftësi të kufizuara të cilët ballafaqohen me barriera të ndryshme për pjesëmarrje në jetën shoqërore.

Çka nënkupton termi aftësi e kufizuar?

Në kuptimin më të thjeshtë të fjalës, termi "aftësi e kufizuar" nënkupton atë çfarë një person nuk mund ta bëjë lehtë, pa ndonjë ndihmë apo mjet lehtësues përderisa të tjerët do të mund ta bënin pa ndonjë vështirësi të madhe.

Është shumë vështirë të përkufizohet kufiri i personit me aftësi të kufizuara dhe atij pa aftësi të kufizuara. Në të vërtetë, gjatë jetës secilit njeri i ndryshojnë aftësitë, qoftë për shkak të moshës, për shkak të lëndimeve apo sëmundjeve që nganjëherë personin mund ta bëjnë përkohësisht apo përjetësisht me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar mund të sistemohet në katër grupe:

- Personat me aftësi të kufizuara fizike;
- Personat e verbër dhe me të pamur të dobësuar;
- Personat e shurdhër; dhe
- Personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe mendore.

Mundësia që çdo individ, në çdo vend dhe me ato mundësi që zotën të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme pa hasur në barriera në ambientin që e rrethon, e përbën qasjen e plotë në ambientin ndërtues dhe mundësinë e qasjes edhe në rrethin social, arsimor e kulturor.

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, në masë të madhe janë të përjashtuar nga proceset edukativo-arsimore, gjë e cila dukshëm ndërlidhet me krijimin e kushteve të përshtatshme në hapësirat të cilat u lehtësojnë atyre pjesëmarrjen e plotë në shoqëri me bashkëmoshatarët.

Mungesa e qasshmërisë në hapësira dhe objekte publike mohon lëvizjen e lirë dhe të pavarur të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti ato arsimore i cili është parakusht për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të tyre në shoqëri. Papërshtatshmëria e objekteve publike, rrugëve dhe transportit i përjashton ata nga shërbimet dhe të mirat publike, njëherazi duke ua mohuar edhe të drejtat për qasje në arsim, shërbime shëndetësore dhe shërbime të tjera publike në përgjithësi dhe i shpie ata drejt një izolimi të pavullnetshëm. Shkaktar i kësaj gjendje është edhe mos zbatimi i kornizës ligjore nga institucionet e vendit dhe vetëdija e ulët e shoqërisë.

Lëvizja e lirë garantohet edhe nga Konventa e kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KKBDPAK, 2006), e cila me Nenin 9 përcakton obligimet e shteteve që ndër të tjera, personave me aftësi të kufizuara t'u ofrohet qasje në ndërtesa, rrugë, transport dhe objekte të tjera në ambientet e brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore dhe ambientet e punës.

Sot në Kosovë ndërtimet e reja siç janë: objektet arsimore institucionale, rrugët, trotualet, mjetet e transportit e shumë të tjera, megjithëse vërehen disa lëvizje pozitive, ende mbesin të pa përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, përkundër faktit të ekzistimit të Ligjit Nr. 04/L – 110 për ndërtim, i cili ndër të tjera rregullon qasjen dhe përshtatjen e objekteve, rrugëve dhe ambientit për personat me aftësi të kufizuara, të specifikuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky udhëzim administrativ ka dispozita obliguese për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, që nga fazat e projekteve deri tek pranimet teknike të objekteve ndërtimore. Gjithashtu, ka dispozita edhe për përshtatjen e objekteve ekzistuese, duke obliguar të gjithë përgjegjësit e institucioneve dhe subjekteve tjera që ofrojnë shërbime për publikun, të përshtatin objektet për lehtësim të qasjes për personat me aftësi të kufizuara.

Për të arritur këtë, ne synojmë që qasjen e përshtatshme nëpër objektet publike arsimore dhe infrastrukturë ta bëjmë prioritet të politikave lokale dhe kombëtare të vendit tonë. Ta rrisim vetëdijen dhe nivelin e përgjegjësisë të zyrtarëve publik, përgjegjës për krijimin e qasjes së përshtatshme për të gjithë fëmijët në Kosovë, qasje e cila u përshtatet nevojave të ndryshme dhe e cila i mundëson tërë popullatës lëvizje të lirë dhe pa pengesa.

Afrim Maliqi,
Drejtore i HANDIKOS



HYRJE

Konteksti i studimit

Lëvizjen në mjedisin fizik shumë prej nesh e marrim si diçka të mirëqenë. Pengesat, kalimet e ngushta, pragjet, shkallët – i kapërcejmë pa shumë mund, shumë herë gjatë ditës, si në hapësirë të hapur publike ashtu edhe në ndërtesa. Vështirësitë për të lëvizur lirshëm, për të arritur destinacione të caktuara në qytet, si dhe për ta shfrytëzuar mjedisin e ndërtuar, gjatë kryerjes së detyrave të përditshme, pastaj mungesa e qasjes fizike në hapësirë publike, në ndërtesa dhe në shërbime, janë disa nga problemet me të cilat përballen grupe të ndryshme të qytetarëve, në veçanti personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore. Në momente të caktuara, me këto pengesa mund të përballen edhe të moshuarit, gratë shtatzëna, fëmijët e vegjël, të sëmurët, udhëtarët, punëtorët, etj. Të gjitha pengesat në mjedisin fizik, elemente konstruktive që pengojnë lëvizjen apo shfrytëzimin e mjedisit të ndërtuar nga ana e qytetarëve të caktuar, i quajmë barriera arkitektonike [1].

Lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara nuk e kufizojnë vetëm pengesat fizike. Barrierat arkitektonike janë të pranishme në mjedisin e ndërtuar falë pengesave që ndryshe i quajmë barriera kulturore dhe institucionale. Barrierat kulturore në të shumtën e rasteve përbëhen nga qëndrimet paragjyquese që qytetarët e ndryshëm i kanë për personat me aftësi të kufizuara. Në grupin e këtyre qytetarëve bëjnë pjesë edhe vetë arkitektët dhe zyrtarët e ndryshëm komunalë, të cilët, të shtyrë nga perceptimet personale të ngjyrosura nga paragjykimet kulturore ndaj aftësisë së kufizuar, prodhojnë, zbatojnë dhe autorizojnë intervenime në mjedisin e ndërtuar të cilat kufizojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara. Si rrjedhojë, mund të themi se mjedisi i ndërtuar i paqasshëm për personat me aftësi të kufizuara është produkt i drejtpërdrejtë i planifikimit dhe projektimit të pakujdesshëm të mjedisit të ndërtuar, që i përjashton apriori nevojat hapësinore të këtij komuniteti në veçanti dhe komuniteteve të tjera në nevojë, duke u udhëhequr nga bindja se personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të kontribuojnë në jetën shoqërore.

Me rritjen e vetëdijes shoqërore mbi ndërlidhjen e drejtpërdrejtë të barrierave të ndryshme, përfshirë këtu pengesat mjedisore dhe shoqërore, si agjentë thelbësorë të kufizimit të mundësisë së integritetit në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara, si dhe pas hyrjes në fuqi të një numri të dokumenteve ndërkombëtare, aktualizimit të të drejtave të njeriut përmes veprimeve të shoqërisë civile, çështja e mundësisë së qasjes në mjedisin e ndërtuar, por edhe qasjes në informatë dhe komunikim, fillon të rregullohet përmes mekanizmave ligjorë dhe politikave kombëtare integruese. Ekzistojnë dokumente të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që ekskluzivisht mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,[2] tashmë është miratuar nga një numër i madh shtetesh dhe organizmash ndërkombëtarë dhe është përfshirë në legjislacionet kombëtare.

Përmes aparatit ligjor, siç e thonë Casserly dhe Ormerod (2003), mundësohen argumentet më bindëse për të luftuar diskriminimin shoqëror,[3] në të cilin bëjnë pjesë edhe pamundësimi i qasjes fizike për Personat me Aftësi të Kufizuara. Mekanizmat e mangët ligjorë dhe administrativë krijojnë terrenin e përshtatshëm që i mbajnë gjallë barrierat arkitektonike, të cilat ndryshe i quajmë edhe barriera institucionale. Të gjitha barrierat e sipërpërmendura, i mbajnë gjallë ndasitë sociale, pra izolojnë komunitete të tëra qytetarësh nga zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.

Qasja si koncept ngërthen mundësinë e lëvizjes, arritjes, hyrjes dhe shfrytëzimit të një hapësire/objekti; mundësinë e orientimit, komunikimit dhe marrjes së informatave. Qasja fizike sipas Titchkosky (2011) ndërlikohet edhe me përfaqësimin e fuqishëm politik të pjesëmarrjes dhe identitetit.[4].

Angazhimi për eliminimin e barrierave të ndryshme për të mundësuar qasje në mjedisin e ndërtuar për të gjithë, sot është në hap me shqetësimet globale që mblidhen nën ombrellën e paradigmës së qëndrueshmërisë. Krahas shqetësimeve për mjedisin, burimet gjithnjë e më shumë në zhdukje të energjisë, kjo paradigmë ngërthen edhe shqetësimet e pabarazive shoqërore,[5] që ndër të tjera, rrjedhin edhe nga mjedisi i ndërtuar që nuk u shërben njësoj të gjithëve, për shkak të procesit planifikues dhe projektimit të tij pa përfshirjen e kërkesave dhe nevojave të gjithë popullsisë.

Dokumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtën për shkollim për të gjithë fëmijët pa dallim janë të shumtë, duke nisur nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF, 1989),[6] Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KKBDPAK, 2006), e deri te vizionet për zhvillimin global të mijëvjeçarit të ri që përfaqësohen nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ, O. 4; T. 4. a, I. 4. a. 1.; 2015).[7]

**Qasja
ngërthen mundësinë e
lëvizjes, arritjes, hyrjes
dhe shfrytëzimit të
një hapësire/objekti;
mundësinë e orientimit,
komunikimit dhe marrjes
së informatave**


Ligji për Arsimin Parauniversitar [8] të Republikës së Kosovës, në disa nene e rregullon ofrimin e shkollimit për të gjithë. Neni 3 me dispozitat e veta siguron që asnjë fëmijë nuk do t'i mohohet e drejta për shkollim. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe komunat e kanë për detyrë krijimin e të gjitha kushteve për ta vënë në zbatim këtë parim të këtij ligji. Neni 39 dhe 40 në veçanti merren me përkufizimet themelore dhe kriteret për akomodimin e gjithë fëmijëve në institucionet arsimore pavarësisht aftësive fizike, intelektuale, sociale, etj. Po ashtu, ky ligj përcakton që komunat duhet të përshtatin ndërtesat shkollore për të komoduara fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përkundër se këto dispozita ligjore në Kosovë e bëjnë të qartë që ekziston korniza ligjore përkrahëse për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e rregullt mësimor në arsimin parauniversitar, numri i vogël i këtyre fëmijëve që ndjekin shkollimin si dhe ndërtesat jomiqësore për t'i pranuar këta fëmijë, tregojnë që Kosova ka ende punë të madhe për të kryer, për t'i arritur standardet ndërkombëtare të gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

HANDIKOS me mbështetje të UNICEF-it, zyra në Kosovë, në kuadër të projektit "Avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë" nga muaji nëntor i vitit 2019 si dhe përgjatë vitit 2020, ka realizuar një hulumtim për mundësinë e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në ndërtesat e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, në shtatë rajonet e Kosovës. Ky hulumtim ka për qëllim pasqyrimin e situatës reale të vështirësive me të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë ballafaqohen përgjatë procesit të përfshirjes në edukimin e rregullt, kryesisht e ndërlidhur me qasjen fizike që shkollat në Kosovë ofrojnë. Për më tepër, të gjeturat e vlerësimit do të udhëzojnë apo sugjerojnë disa nga mundësitë e integritimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e obligueshëm në Kosovë.

Edhe pse e rregulluar me Udhëzimin Administrativ U. A. 33/2007, që është aneks i ligjit të Ndërtimit, e normuar përmes "Udhëzimit për Norma dhe Standarde për Ndërtesa Shkollore" nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me disa dispozita të kuadrit ligjor kosovar, për shkak të mungesës së mekanizmave zbatues në të dy nivelet (nivele lokal dhe qendror), situata aktuale e qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në ndërtesa shkollore vazhdon të jetë jashtëzakonisht problematike. Rrjedhimisht, fëmijët me aftësi të kufizuara e kanë të pamundur realizimin e plotë të të drejtave të tyre të cilat garantohen me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KKBDPAK), Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), dhe Ligjit për Arsimin parauniversitar në Kosovë, si dhe dokumente të tjera për jetë të pavarur dhe të dinjitetshme.



Hulumtimi nxjerr në pah shumë barriera arkitektonike që i bëjnë shkollat jo miqësore për personat me aftësi të kufizuara. Ndër problemet më kritike që e pengojnë qasjen dhe shfrytëzimin e këtyre ndërtesave nga fëmijët me aftësi të kufizuara janë: rampat qasëse me pjerrtësi jo standarde dhe/apo të pa pajisura me mbajtëse të përmasave dhe formave që përcaktohen sipas normave projektuese; mungesa e tualeteve për PAK, apo tualete me përmasa dhe pajisje të papërshtatshme; mungesë e parkingjeve për PAK; mungesë e ashensorëve apo pajisjeve tjera ndihmëse për kapërcimin e disniveleve dhe kateve në brendi të ndërtesës, etj.

Raporti me rezultatet e hulumtimit paraqet një situatë kritike në nivel mbarëkombëtar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta dhe dëshmon se është koha e fundit që të bëhen intervenime për eliminimin e barrierave arkitektonike në këto ndërtesa, për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe pa pengesa, e si rrjedhojë edhe shfrytëzimin e infrastrukturës shkollore nga ana e fëmijëve me aftësi të kufizuara. E gjitha kjo si parakusht për sigurimin e qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe komunitetet e tjera. Ambicia e një Kosove gjithëpërfshirëse do të siguronte një të ardhme më të mirë, të ndërtuar nga kontributi i të gjithëve dhe për të gjithë.

Me qëllim të vlerësimit të mundësisë së integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar, nga dhjetori 2019 si dhe përgjatë vitit 2020, u finalizua vlerësimi i cili mbledhi informatat rreth shkallës së arritshmërisë/qasjes për persona me aftësi të kufizuara në shkollat e ciklit të ulët dhe të mesëm të ulët në shtatë regjionet e Kosovës. Me qëllim të identifikimit të barrierave kyçe që fëmijët me aftësi të kufizuara hasin gjatë procesit të integritit në procesin arsimor, është hartuar një instrument matës i cili përmban informata të përgjithshme rreth lokacionit, veprimtarisë dhe emrit të institucionit lidhur me:

Instrumenti matës është hartuar nga autorja e hulumtimit për të njëjtin qëllim, përderisa është administruar nga hulumtuesit e terrenit (shih Shtojca 2) në regjionet e targetuara dhe në koordinim me profesionisten e punës sociale, punëtore e organizatës HANDIKOS. Të gjithë hulumtuesit paraprakisht janë trajnuar për administrimin e instrumentit matës.

Në bashkëpunim me HANDIKOS dhe duke u bazuar në numrin e shkollave të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë[9], u llogarit madhësia orientuese e mostrës së shkollave që do të vlerësoheshin. Gjatë përzgjedhjes së shkollave që iu nënshtruan vlerësimit, jemi kujdesur posaçërisht që numri i përzgjedhur të jetë i balancuar ndërmjet komunave përbërëse të regjionit, si dhe të ketë përfaqësim të balancuar ndërmjet shkollave të qendrave urbane dhe atyre rurale. Metoda e rastësishme e përzgjedhjes së shkollave për vlerësim në nivel regjioni kishte për qëllim krijimin e një pasqyre të përgjithshme të kapaciteteve të shkollave kosovare për të akomoduar nxënësit me aftësi të kufizuara. Përrashtim nga kjo lloj përzgjedhjeje u bë me regjionin e Prishtinës, që mbledh një numër shumë më të madh komunash. Në këtë rast është marrë një numër më i madh i shkollave në Prishtinë dhe rrethinë, ndërsa komunat e tjera kanë një përfaqësim më të vogël. Madhësia e mostrës prej 144 shkollave u nxor si vlerë ndërmjet mostrës reprezentative dhe asaj minimale, me shkallë të margjinës së gabimit 90%.

Gjithsej, janë vlerësuar 144 ndërtesa shkollore, apo 15 përqind e të gjitha shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë. Orientimisht, numri i përgjithshëm i nxënësve në 144 shkollat e përfshira në hulumtim është 50.550, ndërsa vetëm 2% e atyre nxënësve vlerësohet të jenë fëmijë me aftësi të kufizuara, sipas informatave që Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë ofruar për HANDIKOS.

METODOLOGJIA

- **Hyrjet në ndërtesë dhe hapësirat përreth ndërtesës:** elementet arkitektonike që e mundësojnë qasjen deri te hyrja në ndërtesë; parkingjet për persona me aftësi të kufizuara, qasjet deri tek hyrja, rampat (pjerrinat), shkallët e jashtme, fushat/sipërfaqet taktore udhëzuese dhe ato paralajmëruese që çojnë deri tek hyrja(et) kryesore në ndërtesë, shenjat e qasjes, planin e orientimit;

Hapësirat e brendshme të ndërtesës: qasjen në brendi dhe mundësinë e lëvizjes horizontale dhe vertikale ndërmjet kateve të ndërtesës, shkallët e brendshme, rampat, përmasat e hapësirave.

Ekzistimi i tualeteve të qasshme për persona me aftësi të kufizuara dhe pajisja e tyre, denivelimet, vijat taktore për lëvizje horizontale në ndërtesë, si dhe vijat kontrastuese në shkallë dhe denivelime, ashensori dhe përmasat e tij, shenjat e qasjes, sportelet (aty ku janë), hapësira për lëvizje me karrocë në klasa.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe edukimi

Puna në terren përfshinë vizitën e secilës shkollë të përzgjedhur për hulumtim. Për të plotësuar instrumentin, hulumtuesit duhet të vizitonin ndërtesën në eksterier dhe në enterier (aty ku iu është lejuar). Përpos këtij vëzhgimi, puna përfshinë edhe verifikimin përmes matjeve të përmasave të disa hapësirave apo elementeve të komunikimit vertikal dhe horizontal. Këto përmasa janë të nevojshme për të vlerësuar nëse hapësirat e caktuara apo elementet komunikuese janë të përshtatshme për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara. Disa pjesë dhe elemente problematike në ndërtesat e vëzhguara janë evidentuar edhe përmes fotografimit (shih shtojca 5).



PARAMETRAT KRYESORË TË QASJES

Në ndërtesat shkollore të vlerësuara

Në Kosovë çështja e mundësisimit të qasjes për persona me aftësi të kufizuara në mjedisin e ndërtuar rregullohet përmes Udhëzimit Administrativ 33/2007, që për bazë ka Ligjin e Ndërtimit. As Ligji i Ndërtimit e as ligjet tjera që mbulojnë ndërtimin dhe mjedisin e ndërtuar nuk kanë asnjë nen, paragraf apo edhe fjalë në fjalorin e përdorur gjatë hartimit të tyre që ndërlidhen me konceptet e qasjes për persona me aftësi të kufizuara, shfrytëzim universal apo projektim universal (për të gjithë). Prandaj, U. A. 33/2007 mbetet dokumenti themelor që përmbledh standardet kombëtare për sigurimin e qasjes. Ndërsa sa i përket arsimit parauniversitar, siç u tha edhe më lart, siguri i qasjes fizike në ndërtesat shkollore specifikohet edhe në ligj, por edhe në Udhëzuesin që përmbledh normat dhe standardet kombëtare për ndërtimin e shkollave në Kosovë. Në vëllimin e parë të "Udhëzuesit për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore" specifikohet që sa i përket normave për akomodimin e kërkesave të nxënësve me aftësi të kufizuara, normat projektuese të përmbledhura në udhëzues bazohen në Udhëzimin Administrativ 33/2007. Për qëllime të studimit, janë marrë në konsideratë këto parametra qasëse (parkingjet; rampat; tualetet; ashensorët; taktoret; shkallët; hapësirat; hyrjet; dhe shenjëzimet), të ilustruara edhe me fotografi (shih shtojca 3).

Parkingjet

Ky parametër i rëndësishëm i sigurimit të qasjes së papenguar të personave me aftësi të kufizuara të ndërtesat publike, sipas U. A. 33/2007, kërkon që së paku 1 në 50 vendparkime të përcaktohet për parkim të makinave të personave me aftësi të kufizuara. Në rast të numrit më të vogël të vendparkimeve të përgjithshme, kërkohet medoemos vendosja e një vendparkimi me përmasa për të akomoduar hapësirën e nevojshme për hyrjen dhe daljen nga makina e personave me aftësi të kufizuara. Përmasat standarde të këtij parkingu janë jo më të vogla se 370 cm (220 + 150) x 500 cm sipas rekomandimit të U. A. 33/2007. Udhëzuesi me normat dhe standardet për ndërtimin e shkollave nga MASH-i, te 3.8.2. (a) përmasat për parking të veçantë i jep 380 cm x 500 cm. Këto përmasa janë 150 cm më të gjera prej përmasave standarde, hapësirë kjo e nevojshme për lëvizje me karrocë.

Këto parkingje sipas standardeve ndërkombëtare, përpos përmasave të nevojshme për afrimin me karrocë, duhet domosdoshmërisht të shenjohen me simbolet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar në horizontale (sipërfaqja e parkingut) dhe me shenjëzim vertikal. Në ndërtesa publike, ku hyjnë edhe shkollat, këtyre parkingjeve, që në këtë rast mund të shfrytëzohen nga prindërit/kujdestarët e fëmijëve, zakonisht iu rezervohet vendi në afërsi të menjëhershme të hyrjes së qasshme. Bazuar në parametrat e lartpërmendur, shkollat të cilat gjatë vlerësimit nuk janë hasur vendet e dedikuara me përmasa standarde për parkingje për persona me aftësi të kufizuara dhe të shënuara me shenja standarde vertikale dhe horizontale të qasshmërisë, janë vlerësuar si shkolla që nuk kanë parkingje për PAK.

Rampa qasëse

Rampat janë elementet themelore komunikuese që mundësojnë kapërcimin e disniveleve në hapësirë të hapur dhe në ndërtesa. Për të qenë lehtësisht të kapërcyeshme nga personat me aftësi të kufizuara, përmasat e tyre duhet të jenë të projektuara sipas standardeve. Përmasa kritike e rampave është pjerrtësia ose rënia, e cila si përmasë zakonisht jepet në përqindje (%). Në nenin 10 të U. A. 33/2007 jepen kriteret kombëtare në fuqi, të bazuara në standardet ndërkombëtare, për lartësitë dhe pjerrtësitë e lejuara që mund të kapërcehen lehtësisht nga përdorues karrocash. Pjerrtësia e lejuar për disnivele prej 120 cm është 5 %. Me përjashtime deri 8.33% në rastet kur lartësia që duhet të kapërcehet është deri 76 cm. Në disa raste, përjashtime bëhen edhe kur lartësia është më e madhe se 120 cm dhe ka hapësirë të mjaftueshme, ku mund të realizohet rampa me pjerrtësi 5%.

Sipas udhëzuesit të MASH-it me norma dhe standarde për ndërtimin e shkollave, rekomandohet pjerrtësia maksimale e rampës prej 5%. Kusht tjetër për të qenë rampa lehtësisht e shfrytëzueshme është pajisja me mbajtëse standarde në të dy anët e rampës; gjerësia e rampës 120 cm, si dhe në çdo 6 m gjatësi të rampës medoemos duhet të vendosen pushimore me gjatësi minimale 150 cm.

Në kuadër të këtij hulumtimi, rampat që nuk i plotësojnë kushtet e mësipërme, janë vlerësuar si rampa që s'i përmbushin standardet e qasjes për persona me aftësi të kufizuara.

Tualete të qasshme

Tualeti i qasshëm për PAK është një nga kriteret themelore të qasshmërisë dhe shfrytëzueshmërisë së një ndërtese nga PAK. Tualetet e tilla duhet të kenë përmasat dhe pajisjet e duhura që të jenë lehtësisht të shfrytëzueshëm nga përdorues karrocash. Në nenin 18 të U. A. 33/2007 jepen kriteret kombëtare të bazuara në standardet ndërkombëtare të projektimit dhe të pajisjes së këtyre tualeteve. Në nenin 3.8.3. të Udhëzuesit me norma dhe standarde për ndërtesa shkollore të MASH-it, shkolla duhet të jetë e pajisur me së paku një tualet të qasshëm, me përmasa 170 cm x 170 cm, me derë të gjerë prej 100 cm dhe pajisje standarde sanitare për të akomoduar nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë vizitave të realizuara në shkolla, në rastet kur është vërejtur mungesa e pajisjeve të tualetit për PAK, përmasat jashtë standardit të hapësirës dhe bllokimi/mbyllja e hapësirës së tualetit nga ana e menaxhmentit, hulumtuesit kanë vlerësuar se tualeti për PAK nuk ekziston ose nuk është i qasshëm.

Ashensorë të qasshëm

Për kapërcimin e disniveleve të mëdha – kateve nga ana e PAK në ndërtesa që i shërbejnë publikut të gjerë, është i domosdoshëm instalimi i ashensorit. Neni 12 në U. A. 33/2007 jep përmasat dhe pajisjen e ashensorëve për të qenë të shfrytëzueshëm nga ana e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore. Këta parametra përshkruhen edhe në kapitullin 3.8.2 të Udhëzuesit me normat dhe standardet kombëtare për ndërtimin e ndërtesave shkollore.

Sipërfaqet taktore dhe planet orientuese

Këto janë elemente të rëndësishme për lëvizjen dhe shfrytëzimin e një ndërtese nga ana e personave të verbër. Në U. A. 33/2007 kriteret për pajisjen e sipërfaqeve publike dhe ndërtesave që i shërbejnë një publiku të gjerë rregullohen përmes nenit 8. Këto zakonisht duhet të paraqiten në formën e shiritave udhëzues që çojnë drejt hyrjeve në ndërtesë, orientojnë lëvizjen në brendi të ndërtesës dhe përmbajtjeve të rëndësishme, si dhe paraqiten në formën e fushave paralajmëruese që vendosen para disniveleve, elementeve të komunikimit vertikal në ndërtesë (shkallë, ashensor) dhe përmbajtjeve të caktuara në ndërtesë. Forma e tyre, varësisht nga funksioni mund të jetë e brinjëzuar (kur japin drejtim), dhe me "butona" të taktoret paralajmëruese.

Ndërsa planet orientuese, të cilat janë burime të rëndësishme informatash për orientim në hapësirë, që realizohen në relief dhe shkrimin Braille për personat e verbër, në këtë U. A. rregullohen në nenin 35.

Shkallët dhe disnivelet e qasshme

Për personat me shikim të dobësuar, ku hyjnë edhe të moshuarit, kapërcimi i disniveleve është mjaft problematik. Shpeshherë, këta persona mund të kenë probleme me perceptimin e thellësisë, por edhe me qartësinë e sipërfaqeve horizontale. Në këso rastesh, për të paralajmëruar rreziqet potenciale gjatë kapërcimit të nivele, përdoret shenjëzimi i skajit të shkallëve apo disniveleve me shirita kontrastues koloristik me gjerësi 2 cm. Disa standarde të shteteve të BE-së kërkojnë që kontrasti koloristik i shiritit të jetë rreth 70% në raport me sipërfaqen e veshjes kryesore të dyshemesë ku paraqitet disniveli apo të shkallëve. Për t'i bërë të qasshme shkallët për personat me shikim të dobësuar jepen kriteret standarde, ndër shumë kritere të tjera për t'i bërë shkallët lehtësisht të kapërcyeshme edhe nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuara në nenin 11 të U. A. 33/2007. Ndërsa, në udhëzuesin e MASH-it me normat dhe standardet kombëtare për ndërtimin e shkollave, për lehtësimin e kapërcimit të disniveleve kërkohet që tek shkallët secili basamak të ketë ngjyrë tjetër. Gjatë vlerësimit në shkolla, të dy këto kritere janë marrë parasysh.

Shenjëzimet qasëse

Shenjëzimi qasës është informatë shumë e rëndësishme për persona me aftësi të kufizuara për pajisjen e ndërtesës apo hapësirës me elemente qasëse që ndihmojnë lëvizjen dhe shfrytëzimin e pavarur të ndërtesës nga këta persona.


Për shenjëzim shfrytëzohen simbolet sipas standardeve ndërkombëtare që vihen vertikalisht dhe horizontalisht te hapësirat, ndërtesat dhe kthinat që janë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara.



Hapësirat për lëvizje në klasë

Neni 21 i U. A. 33/2007 i jep kriteret për shfrytëzimin e dhomave dhe klasave nga persona me aftësi të kufizuara, përdorues karrocash. Ndër të tjera, për përdoruesit e karrocave kërkohet që rreth orendive të klasave të ketë hapësirë minimale prej 120 cm. Ndërsa komunikimi horizontal në klasë të ketë gjerësi minimale prej 150 cm. Këto i parashtron edhe udhëzimi i MASH-it me norma dhe standarde për ndërtesat shkollore.

Ndër të tjera, normat e MASH-it për madhësinë e hapësirës së klasës dhe kapacitetit të saj, duhet të përcaktohen duke marrë parasysh edhe kërkesat e nxënësve me aftësi të kufizuara.



PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE

Në kuadër të hulumtimit për qasjen e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta janë përfshirë 144 ndërtesa shkollore në shtatë regjione të Kosovës dhe në gjithsej 30 komuna (shih shtojca 1). Ato janë vlerësuar duke u bazuar në parametrat e përshkruara sipër. Më poshtë janë paraqitur të gjeturat e përgjithshme nga terreni në nivel vendi për 144 shkollat e vlerësuara, të gjetura të ndara sipas parametrave vlerësues.

Parkingjet

Në asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka parking të dedikuar, të projektuar me përmasa standarde dhe të shënuar me shenja qasëse horizontale dhe vertikale për persona me aftësi të kufizuara.

Rampat

Nga 144 shkolla të vlerësuara, **10 (7%)** nga to është vlerësuar të mos kenë nevojë për rampë, **27 (19%)** shkolla nuk kanë fare rampë, përdorisa në 81 (56%) shkolla ekziston rampa por që nuk përmbush standardet. Vetëm në 28 shkolla është identifikuar rampa sipas standardeve.

Tualetet për PAK

Në **107 (74%)** shkolla të vlerësuara nuk janë identifikuar fare tualete të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në **27 (19%)** shkolla nga 144 të vlerësuara janë identifikuar tualetet e qasshme për PAK, gjithsesi ato janë në shfrytëzim për nevoja të tjera të shkollës (kryesisht depo sanitare). Në anën tjetër, në vetëm **10 (7%)** shkolla janë identifikuar tualetet e qasshme.

Ashensorët e qasshëm

Në asnjë shkollë nuk është identifikuar ashensor i qasshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara, në përjashtim të **një (1)** shkollë e cila posedon ashensor por që është jashtë përdorimit. Nga 144 shkollat e vlerësuara, në vetëm **15** prej tyre është vlerësuar se nuk ka nevojë për ashensor pasi që mësimi zhvillohet vetëm në një nivel apo kat.

Sipërfaqet taktore dhe planet orientuese

Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në shtatë regjionet e Kosovës. Gjithashtu, asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka shkallë të pajisura me shirita kontrastues në basamakë për lëvizjen e personave me shikim të dobësuar. Në disa shkolla ekzistojnë shkallë të brendshme me basamakë të punuara me ngjyra të ndryshme (sipas normave të MASH për ndërtesa shkollore), por jo edhe sipas U. A. 33/2007, që ndihmojnë lëvizjen e nxënësve me probleme pamore. Te lyerja e basamakëve me ngjyra të ndryshme duhet të kihet parasysh shkalla e shkëlqimit dhe e kontrastit prej njërit basamak te tjetri.

Shenjëzimet qasëse

Nga vlerësimet e parametrave pjesë të studimit, shenjëzime qasëse janë identifikuar në vetëm **dy (2)** shkolla, pavarësisht barrierave të tjera arkitektonike të identifikuar në këto shkolla. Shenjëzime të pjesshme janë identifikuar në shumë pak shkolla të vlerësuara.

Hapësirat për lëvizje në klasë

Nga 144 shkollat e vlerësuara, vetëm **33** shkolla (**23%**) është vlerësuar të mos kenë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje në klasë për fëmijët përdorues të karrocës.

TË GJETURAT NË NIVEL REGJIONAL

Më poshtë janë të paraqitura të gjeturat nga vlerësimi i 144 shkollave në Kosovë, të ndara për shtatë (7) regjionet e targetuara/pjesëmarrëse në hulumtim. Të gjeturat reflektojnë nivelin e qasjes që ofrohet për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpër regjione të ndryshme, duke përfshirë numrin e shkollave të vlerësuara për atë regjion, nivelin e qasjes që ofrojnë si dhe problematikat kyçe të identifikuar gjatë vlerësimit në terren.

Në regjionin e Prishtinës janë vlerësuar 27 shkolla nga shtatë (7) komuna të ndryshme. Nga shkollat e vlerësuara, 11 shkolla janë nga zonat urbane dhe 16 nga ato rurale (shih Shtojca 1).


Më poshtë paraqiten të gjeturat kyçe të identifikuar në shkollat e vlerësuara në regjionin e Prishtinës, të ndara sipas parametrave vlerësues.

Në regjionin e Prishtinës, asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka parking të përmasave standarde për PAK dhe të shënuar sipas simboleve standarde ndërkombëtare. Në anën tjetër, nga 27 shkollat e vlerësuara, 14 prej tyre janë të pajisura me rampë, mirëpo jo sipas standardeve; 5 shkolla nuk kanë fare rampë; ndërsa në 2 shkolla hyrja është në nivel të terrenit. Në vetëm 6 shkolla të vlerësuara është raportuar rampa e qasshme sipas udhëzimeve dhe standardeve. Shih grafikonin më poshtë për më shumë detaje:

Në qytetin e Prishtinës ka shkolla që janë shumë të mëdha dhe rrjedhimisht kanë disa hyrje. Nga vlerësimi është vërejtur që shpeshherë vetëm njëra hyrje është e pajisur me rampë standarde, përderisa të tjerat mund të mos përmbajnë fare apo mund të kenë rampë të papërshtatshme për shfrytëzim nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Një nga shkollat më të frekuentuara në qytetin e Lipjanit, ka një rampë me pjerrtësi brenda përqindjes të lejuar, por nuk ka fare mbajtëse.


Shkollat janë vlerësuar edhe në parametrin e tualetit të qasshëm për fëmijë. Një nga shkollat më të mëdha të Prishtinës, nuk ka fare tualete të qasshme për PAK. Një shkollë në fshatin Matigan, i cili tashmë është pjesë e zonës urbane të Prishtinës, ka tualet të dedikuar për persona me aftësi të kufizuara, por dera e tualetit ka prag të lartë, gjë e cila pamundëson shfrytëzimin e këtij tualeti nga nxënës që përdorin karroca.

REGJIONI I PRISHTINËS



Grafikoni 1. Numri i shkollave me rampa në regjionin e Prishtinës

Një tjetër shkollë në Prishtinë, nuk ka fare tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuara. Nga observimi në ndërtesë, vërehet një hapësirë që ndoshta në fazën e projektimit ka qenë e dedikuar për këto tualete, por ajo nuk është e kompletuar me pajisje standarde dhe mbahet e mbyllur me çelës, për shkak se shfrytëzohet nga arsimtarët e shkollës. Në Prishtinë, një nga shkollat e vlerësuara, tualetin e qasshëm e mban mbyllur me çelës në orët e paraditës, kur mbajnë mësim fëmijët e ciklit të lartë, me arsyetimin se këta nxënës po i dëmtojnë pajisjet e këtij tualeti. Ky tualet hapet pasdite, në orarin e nxënësve të ciklit të ulët. Po ashtu, shkollat që i kanë tualetet e qasshme, nuk i kanë të shënuara ato me simbolet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar. Shënjimi është një nga kriteret e rëndësishme që ndikon në shkallën e qasshmërisë dhe shfrytëzueshmërisë së hapësirave nga PAK. Për më tepër, grafikoni më poshtë, pasqyron qartë pajisjen e tualeteve të qasshme në shkollat e vlerësuara:



Grafikoni 2. Tualetet e qasshme nëpër shkollat në regjionin e Prishtinës

Në 22 shkolla në regjionin e Prishtinës nuk ka fare ashensor, përderisa në 5 shkolla, ashensori nuk është i domosdoshëm (mësimi zhvillohet në katin e parë). Duhet theksuar se shkolla "Naim Frashëri" në Prishtinë, për kapërcimin e disnivelit të brendshëm që është pasojë edhe e terrenit të pjerrët, e ka të instaluar një platformë palosëse në murin e shkallëve.

Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në regjionin e Prishtinës, po ashtu nuk janë identifikuar shkallë të pajisura me shirita kontrastues. Nga hulumtimi në regjionin e Prishtinës, te një shkollë e komunës së Novobërdës ekziston një shenjë qasëse sipër derës së tualetit të qasshëm, si dhe në një tjetër shkollë në Prishtinë ekziston një shenjë qasëse tek dera e hyrjes, edhe pse kjo shkollë nuk ka pajisje të mjaftueshme qasëse për t'u kualifikuar ndërtesë e qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në anën tjetër, në 3 shkolla të vlerësuara nuk është raportuar hapësirë e mjaftueshme për lëvizje të lirë nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Në një shkollë në komunën e Prishtinës vlerësohet se për shkak të numrit dhe mënyrës së organizimit të orendive të brendshme, ka klasa që nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje me karroca të fëmijëve me aftësi të kufizuara.


Parregullsi të identifikuar në shkollat e vlerësuara janë ilustruar edhe me fotografi në shtojcën 4.

REGJIONI I GJAKOVËS

Në regjionin e Gjakovës janë vlerësuar 20 shkolla në 4 komuna të ndryshme, prej të cilave 14 janë në zona urbane dhe 6 në zona rurale. Më poshtë paraqiten të gjeturat kyçe të identifikuar në shkollat e vlerësuara në regjionin e Gjakovës, të ndara sipas parametrave vlerësues.

Në regjionin e Gjakovës, asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka parking të përmasave standarde për PAK dhe të shënuar sipas simboleve standarde ndërkombëtare.

Në 14 shkolla të vlerësuara është raportuar ekzistenca e rampës, megjithatë është vlerësuar jashtë standardeve. Në anën tjetër, nga 20 shkolla të vlerësuara, 4 prej tyre nuk kanë fare rampë dhe në 2 shkolla nuk është e nevojshme rampa (hyrja është në nivel terreni). Grafikoni më poshtë paraqet përmblendhjen e të gjeturave në regjionin e Gjakovës, në parametrin e rampës së qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.




Grafikoni 3. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Gjakovës

Në 18 shkolla nga ky regjion nuk është raportuar ekzistenca e ashensorit, përderisa asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten në 20 shkollat e vlerësuara, e gjithashtu nuk ka shkallë të pajisura me shirita kontrastues.

Nga 20 shkolla të vlerësuara, vetëm në 13 shkolla është vlerësuar të ketë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje të lirë të fëmijëve, përdorues të karrocës, në klasat e shkollës.

Në 12 shkolla nuk është raportuar ekzistenca e tualetit të qashtëm për fëmijë me aftësi të kufizuara përderisa vetëm në dy (2) prej tyre ekziston tualeti i qashtëm. Në anën tjetër, gjashtë (6) shkolla janë vlerësuar të kenë toalet të qashtëm për fëmijë, megjithatë ato shfrytëohen për qëllime të tjera të shkollës (sanitari, etj.). Asnjë nga toaletet e qashtme nuk janë vlerësuar të kenë shenjëzime qasëse sipas standardeve.



Grafikoni 4. Tualetet e qashtme nëpër shkollat në regjionin e Gjakovës


Shih shtojcën 4 për parregullsitë e identifikuar në shkollat e vlerësuara.

REGJIONI I PEJËS

Në regjionin e Pejës janë vlerësuar 20 shkolla në 4 komuna, prej të cilave 7 shkolla janë në zona urbane dhe 13 të tjera në zona rurale. Më poshtë është paraqitur përmbledhja e të gjeturave nga vlerësimet në terren në këtë regjion, të ndara sipas parametrave vlerësues.

Në regjionin e Pejës, asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka parking të përmasave standarde për PAK dhe të shënuar sipas simboleve standarde ndërkombëtare.

Nga 20 shkollat e vlerësuara në këtë regjion, në 12 prej tyre është identifikuar prezenca e rampës, por që është vlerësuar të jetë jashtë standardeve. Përdërisa në tri (3) shkolla rampa është vlerësuar të jetë me standarde. Një pasqyrë e përgjithshme është paraqitur në grafikonin më poshtë për pajisjen me rampa në shkollat e vlerësuara në regjionin e Pejës:



Grafikoni 5. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Pejës

Në shkollën e vlerësuar në qytetin e Istogut, ekziston rampa me pjerrtësi standarde, por nuk ka pushimore pas 6 m gjatësi. Në Vitimiricë, shtegu për te hyrja kryesore është rrafsh me terrenin, por shtegu ka mjaft dëmtime dhe pengesa, që e bëjnë të pakalueshëm për grupe të caktuara të personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, pas derës kryesore të hyrjes, në brendi të shkollës paraqiten disa shkallë, andaj edhe kjo shkollë klasifikohet që nuk ka fare qasje.

Në regjionin e Pejës, nga 20 shkolla të vlerësuara nuk është identifikuar në asnjë rast, tualeti i qasshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një shkollë në Klinë, përkundër faktit se është ndërtim i vitit 2019, nuk është fare e pajisur me tualete të qasshme, por edhe rampën e ka me pjerrtësi jashtë standardeve (13.8%) mirëpo të pajisur me mbajtëse standarde. Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në regjionin e Pejës, e gjithashtu është raportuar mungesë e plotë e shkallëve të pajisura me shirita kontrastues, e po ashtu mungesë e plotë e shënjimeve qasëse.

Nga 20 shkolla, në 8 prej tyre është raportuar mungesa e hapësirës për lëvizjen e lirë të nxënësve, përdorues të karrocës në klasë. Në 18 shkolla është raportuar mungesa e ashensorit, përdorues në 2 të tjera, ashensori është vlerësuar të mos jetë i domosdoshëm (mësimi zhvillohet në katin e parë).


Disa parregullsi të identifikuara në shkollat e regjionit të Pejës janë ilustruar me fotografi (shih Shtojca 4).

REGJIONI I FERIZAJT

Në këtë regjion janë vlerësuar 20 shkolla në 5 komunat përbërëse të tij. Nga këto 20 shkolla, 12 janë në zona urbane dhe 8 të tjera në zona rurale. Më poshtë janë paraqitur të gjeturat kyçe sipas parametrave vlerësues.

Asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka parking të përmasave standarde për PAK dhe të shënuar sipas simboleve standarde ndërkombëtare. Në një shkollë, ekziston një hapësirë e gjerë përpara hyrjes së shkollës, që sipas të dhënave të marra nga hulumtuesja në terren gjatë intervistimit të mësueseve të shkollës, shpeshherë shërben si hapësirë ku ndalen dhe parkohen makinat që sjellin dhe marrin fëmijët me aftësi të kufizuara. Mirëpo, ajo hapësirë nuk përmban simbolet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar horizontale dhe vertikale për të shënuar se hapësira është e dedikuar ekskluzivisht për persona me aftësi të kufizuara. Andaj, edhe ky parking në këtë hulumtim nuk kualifikohet si parking për PAK.

Në 8 shkolla është raportuar ekzistenca e rampave, por janë vlerësuar jashtë standardeve, përderisa në shtatë (7) të tjera është identifikuar dhe vlerësuar ekzistenca e rampave sipas standardeve. Grafikoni më poshtë paraqet të gjeturat e përgjithshme të 20 shkollave të vlerësuara në parametrin e qasjes:




Grafikoni 6. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Ferizajt

Duhet theksuar që edhe ato rampa që në këtë hulumtim i kemi kualifikuar se i plotësojnë standardet, në të shumtën e rasteve nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e qasshmërisë. Gjatë vlerësimit, nëse një rampë kualifikohet "standarde", është marrë parasysh plotësimi i kriterëve që lidhen me pjerrtësinë e rampës dhe pajisjen me mbajtëse standarde. Këto i kemi vlerësuar si kushte minimale, të domosdoshme për të siguruar qasjen fizike në ndërtesë. Kriteret e gjerësisë së rampës dhe numrit të ndërprerjeve me pushimore (në çdo 6 m) kundrejt gjatësisë së rampës, në shkollat e përfshira në këtë hulumtim, shpeshherë nuk janë plotësuar.

Në rastin e këtij hulumtimi këto kriterë nuk janë marrë si determinante të qasjes minimale në ndërtesë, pavarësisht se janë kriterë që e bëjnë lëvizjen më komode. Kriteri i paraqitjes së pushimoreve në çdo 6 m gjatësi të rampës është kriter shumë i rëndësishëm. Studime të shumta tregojnë se përpjekja fizike e përdoruesve të karrocës për kalimin e gjatësisë prej 6 m në pjerrtësi 5% ose 8.33% është shumë e madhe, andaj ekziston nevoja e lëvizjes në sipërfaqe të rrafshët për minimum 150 cm, për ta bërë më të lehtë përballjen me pjerrtësinë e radhës. Në anën tjetër, në 17 shkolla nga ky regjion është raportuar mungesa e tualeteve të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një tualet i projektuar për PAK në njërin shkollë të Ferizajt mbahet i mbyllur dhe shfrytëzohet si depo nga personeli i mirëmbajtjes së shkollës. Po ashtu, shkollat që i kanë tualetet e qasshme, nuk i kanë të shënuara ato me simbolet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar. Shënimi është një nga kriteret e rëndësishme që ndikon në shkallën e qasshmërisë dhe shfrytëzueshmërisë së hapësirave nga persona me aftësi të kufizuara.

Në 4 shkolla nuk është vlerësuar domosdoshmëria e ashensorit, përderisa ky i fundit mungon plotësisht në shkollat e tjera të vlerësuara. Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara. Po ashtu, nuk kanë shkallë të pajisura me shirita kontrastues e gjithashtu në asnjë nga shkollat nuk është aplikuar asnjë nga shenjat standarde ndërkombëtare të qasjes.

Grafikoni më poshtë paraqet të gjeturat nga hulumtimi në parametrin e lëvizjes së lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përdorues të karrocës në 20 shkolla të vlerësuara në këtë regjion:




Parregullsi të identifikuara në shkollat e vlerësuara në regjionin e Ferizajt janë ilustruar edhe me fotografi, të paraqitura në Shtojcën 4 të raportit hulumtues.

20 shkolla janë vlerësuar sipas parametrave vlerësues në 3 komuna të regjionit të Mitrovicës. Prej tyre, 14 shkolla janë në zona urbane dhe 6 të tjera në zona rurale. Më poshtë janë të paraqitura të gjeturat kyçe në këto shkolla sipas parametrave të vlerësimit.

REGJIONI I MITROVICËS


Nuk janë identifikuar parkingje të qasshme në asnjë nga shkollat e vlerësuara në regjionin e Mitrovicës, sipas standardeve dhe të shënuar sipas simboleve standarde ndërkombëtare.

Në 12 shkolla është identifikuar prezenca e rampës, megjithatë është vlerësuar jashtë standardeve, përderisa vetëm 1 shkollë është e pajisur me rampë të qasshme, e bazuar në standarde dhe udhëzime. Grafikoni më poshtë paraqet një pasqyrë të përgjithshme të situatës së parametrit të qasjes në 20 shkollat e vlerësuara në regjionin e Mitrovicës.



Grafikoni 8. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Mitrovicës

Në shkollën e vlerësuar në fshatin Shipol të komunës së Mitrovicës, ekziston një rampë rreth 30 m gjatësi, me pjerrtësi prej 5%, por nuk ka asnjë ndërprerje për pushimore në intervalet prej 6 m. Në qytetin e Mitrovicës, një nga shkollat e vlerësuara nuk ka fare rampë, përkundër se hyrjen e ka të ngritur nga terreni. Vetëm 1 shkollë në këtë regjion (në qytetin e Mitrovicës) është raportuar të ketë tualet për fëmijët me aftësi të kufizuara, megjithatë i njëjti është vlerësuar i paqasshëm (përdoret për qëllime të tjera). E gjithashtu, në asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk është identifikuar prezenca e ashensorit, pavarësisht faktit se të gjitha shkollat e vlerësuara janë disa katëshe.



Grafikoni 9. Tualetet e qasshme nëpër shkollat në regjionin e Mitrovicës

Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në regjionin e Mitrovicës. Në shkollat e vlerësuara, nuk ka shkallë të pajisura me shirita kontrastues si dhe mungojnë plotësisht shenjëzimet qasëse. Në të gjitha shkollat e vlerësuara është identifikuar hapësirë e mjaftueshme në klasë për lëvizje të lirë të nxënësve me aftësi të kufizuara.


Parregullsi nga terreni janë ilustruar edhe me fotografi të paraqitura në Shtojcën 4.

REGJIONI I PRIZRENIT

20 shkolla të ulëta dhe të mesme të ulëta, në 4 komunat e regjionit të Prizrenit janë vlerësuar. Prej tyre, 14 shkolla janë në zona urbane dhe 6 të tjera në zona rurale. Më poshtë janë paraqitur të gjeturat kyçe nga shkollat e vlerësuara sipas parametrave vlerësues.

Në asnjë shkollë nuk është identifikuar prezenca e parkingjeve të qasshme me shenja qasëse për PAK.

Në 13 shkolla janë identifikuar rampa për fëmijët me aftësi të kufizuara por që janë vlerësuar të paqasshme. Grafikoni më poshtë paraqet pasqyrën e përgjithshme të 20 shkollave të vlerësuara në parametrin e qasjes:




Grafikoni 10. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Prizrenit

Një nga shkollat e vlerësuara në Suharekë ka rampë që e plotëson kriterin e pjerrtësisë (4.5 %), por nuk ka fare mbajtëse, andaj edhe klasifikohet si rampë që nuk i plotëson kriteret standarde. Ndërtesa e një shkolle në lagjen Ortakoll në Prizren, ka rampë që e plotëson kriterin e pjerrtësisë (5.5%), por ngjashëm si shkolla në Suharekë nuk ka mbajtëse, andaj klasifikohet rampë jo standarde.

Në 17 shkolla të vlerësuara është raportuar mungesa e plotë e ashensorit përderisa një shkollë në Prizren, ka ashensor që është jashtë përdorimit. Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në regjionin e Prizrenit. Asnjë nga shkollat e vlerësuara nuk ka shkallë të pajisura me shirita kontrastues, e gjithashtu është raportuar mungesa e plotë e shenjzimeve qasëse.

Të gjeturat nga parametri vlerësues rreth pajisjes me tualet të qasshëm për fëmijë janë paraqitur në grafiknin më poshtë:



Grafikoni 11. Tualetet e qasshme nëpër shkollat në regjionin e Prizrenit

Në një nga shkollat e vlerësuara në Prizren, hulumtuesi nuk ka pasur mundësi t'i qaset tualetit për PAK për ta vlerësuar nëse i ka përmasat dhe pajisjet e duhura, meqë tualeti mbahet i mbyllur nga arsimtarja që jep mësim në klasët me nxënës me aftësi të kufizuara.

Duhet theksuar se në këtë shkollë ndjekin mësimin nxënës me aftësi të kufizuara, por rampa e kësaj shkolle është jashtë standardeve (9.3%).

Në 14 shkolla nga 20 të vlerësuara është raportuar mungesa e hapësirave të nevojshme për lëvizjen e lirë të nxënësve me aftësi të kufizuara, përdorues të karrocave.


Parregullsi të tjera të identifikuar gjatë hulumtimit në terren janë ilustruar edhe me fotografi (shih Shtojca 4).

Gjithsej janë vlerësuar 17 shkolla në 3 komunat e regjionit të Gjilanit, prej të cilave 9 janë në zona urbane dhe 8 të tjera në zona rurale. Më poshtë janë të paraqitura të gjeturat kyçe nga shkollat e vlerësuara sipas parametrave vlerësues.

REGJIONI I GJILANIT

Në asnjë shkollë (nga 17 të vlerësuara) nuk janë identifikuar parkingje të qasshme me shenjëzime qasëse për personat me aftësi të kufizuara.


Në 8 shkolla është identifikuar prezenca e rampës por është vlerësuar jashtë standardeve, përderisa në 6 shkolla është identifikuar rampa me standarde. Grafikoni më poshtë, paraqet pasqyrën e përgjithshme të situatës së shkollave të vlerësuara në parametrin e qasjes:



Grafikoni 12. Numri i shkollave me rampë në regjionin e Gjilanit

Një nga shkollat e vlerësuara në Velekincë ka rampë që e plotëson kriterin e pjerrtësisë, por në gjithë gjatësinë e saj prej 8 m nuk ka asnjë pushimore. Njësoj, edhe një shkollë në Kamenicë, ka një rampë me gjatësi prej 15 m, që plotëson kriterin e pjerrtësisë por nuk ka asnjë pushimore.

Në 10 shkolla të vlerësuara nuk janë identifikuar fare tualete të qasshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, e asnjë nga to nuk i plotëson kriteret e qasshmërisë as për nga përmasat e as për nga mënyra e pajisjes. Shkollat që i kanë tualetet e qasshme, nuk i kanë të shënuara me simbolet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar (përpos SHFMU Selami Hallaqi në Gjilan).



Grafikoni 13. Tulaletet e qasshme nëpër shkollat në regjionin e Gjilanit

Në 15 shkolla, në të cilat do duhej të ekzistonte ashensori, një i tillë nuk është identifikuar prezent, përderisa në 2 shkolla të tjera kjo është vlerësuar jo e domosdoshme (mësimi zhvillohet në katin e parë).

Asnjë nga kriteret për lëvizshmërinë e personave të verbër, si fushat taktore dhe planet orientuese nuk paraqiten te shkollat e vlerësuara në regjionin e Gjilanit. Gjithashtu, asnjë nga shkollat e vlerësuara, nuk ka shkallë të pajisura me shirita kontrastues. Nga hulumtimi në regjionin e Gjilanit, del se vetëm në një shkollë në Gjilan, te tualeti i qasshëm paraqitet shenjzimi qasës, por në pjesët tjera të ndërtesës, sikurse te të gjitha shkollat e vlerësuara të regjionit nuk është aplikuar asnjë nga shenjat standarde ndërkombëtare të qasjes.

Është raportuar që të gjitha shkollat e vlerësuara kanë hapësira të mjaftueshme në klasa për të lëvizur lirshëm nxënësit me aftësi të kufizuara, përdorues të karrocës.

Parregullsi të tjera të identikuara janë ilustruar edhe me fotografi (shih Shtojca 4).

LIMITIMET E VLERËSIMIT


Kufizimet e vlerësimit janë të kategorizuara në dy fusha kryesore të cilat kufizojnë të gjeturat, njëherit edhe janë mësimet e nxëna të cilat do duhej të konsideroheshin në studimet e ardhshme të të njëjtës natyrë.

Përzgjedhja e shkollave për vlerësim u bë nga hulumtuesit në terren. Kjo përzgjedhje u kushtëzua nga njohuritë e tyre të terrenit/regjionit, mundësisë së lidhjeve transportuese, mbulimit të shkollave të një regjioni nga një individ/hulumtues, kufizimeve të shkaktuara nga moti në fund të muajit nëntor dhe dhjetor 2019 dhe kohës së shkurtër prej tre ditësh të paraparë nga projekti për të mbuluar mostrën prej 144 shkollash në të gjitha regjionet e Kosovës. Vështirësi në procesin e punës në terren paraqiste edhe fakti se një regjion mbulohej vetëm nga një hulumtues. Të gjitha këto përbëjnë edhe kufizimet e hulumtimit.

Duhet theksuar se sa i përket shqyrtimit të mjedisit përreth ndërtesës është marrë parasysh vetëm hapësira e menjëhershme që është pjesë e pronës së ndërtesës, apo pjesë e sipërfaqes publike pranë ndërtesës. Sipërfaqja dhe hapësira publike, si dhe elementet përbërëse të saj, infrastruktura rrugore dhe transporti urban nuk janë trajtuar fare në këtë vlerësim. Një vlerësim për shkallën e qasjes fizike në qytet dhe praninë e barrierave arkitektonike në të duhet të përmbajë edhe këtë aspekt të mjedisit të ndërtuar pos qasjes në brendi të ndërtesave.

Në të ardhmen, një vlerësim gjithëpërfshirës i qasjes në nivel të qytetit duhet të kryhet me qëllim të evidentimit të barrierave arkitektonike, për të cilat pastaj do të hartohen plane për eliminim dhe adaptim të ndërtesave dhe mjedisit të ndërtuar në përgjithësi, për të mundësuar lëvizjen dhe shfrytëzimin e lirë të mjedisit të ndërtuar nga të gjithë fëmijët pa dallim.

Të gjeturat e hulumtimit, përveç gjeneralizimit, limitohen edhe në interpretim, rrjedhimisht, i gjithë studimi është i natyrës përshkruese dhe nuk ofrohen modalitete praktike të intervenimit të cilat do ndikonin në avancimin e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend në fushën e edukimit.



KONKLuzionet

Nga rezultatet e vlerësimit të kryer në shkollat e përzgjedhura në 7 regjionet e Kosovës, mund të konkludojmë se ndërtesat shkollore të arsimit të ulët dhe mesëm të ulët në Kosovë janë përplot barriera arkitektonike që janë pengesë serioze për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta dhe gjithë personave me aftësi të kufizuara në arsim. Ky rezultat është shqetësues, duke qenë se prej vitit 2007 ekziston Udhëzimi Administrativ 33/2007 që rregullon ndërtimin e shfrytëzueshëm universalisht dhe përshtatjen e ndërtesave ekzistuese për qasjen e PAK, si dhe që nga viti 2015 përbrenda normave dhe standardeve për ndërtesa shkollore ekzistojnë parametra të përcaktuar për akomodimin e nevojave hapësinore të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Nga rezultatet kuptojmë se përpjekja më e madhe e komunave në përshtatjen e ndërtesave për qasjen e PAK është përqendruar tek ndërtimi i rampave qasëse në hyrje të shkollave. Përveç në rastet e shkollave shumë të vjetra, apo të rasteve të izoluar, shkollat kanë një rampë të jashtme. Mirëpo, në shumicën e rasteve, siç ndodh edhe te shumë ndërtesa të shfrytëzimit publik në Kosovë, këto janë intervenime të çastit, që në realitet nuk zgjidhin por vetëm e maskojnë problemin. Kjo rezulton në rampa që kanë pjerrtësi jashtë standardit (përmbi 5%, gjegjësisht 8.33%), nuk kanë mbajtëse standarde për të asistuar ngjitjen/zbritjen nëpër rampë, materialin mvëshës e kanë jo adekuat, etj. Prandaj, situatat e tilla të hasura gjatë vlerësimit në terren, janë vlerësuar si rampa të pakompletuara sipas standardeve, rrjedhimisht të papërshtatshme për qasje për persona me aftësi të kufizuara.

Shkollat nuk kanë vende të dimensionuara, të shënuara me shenjat ndërkombëtare horizontale dhe vertikale të qasshmërisë për parkingjet për PAK. Tualetet për PAK janë një tjetër kriter kritik për shfrytëzueshmërinë e ndërtesave publike nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Siç është parashtruar në pjesët e mësipërme, bazuar në normat kombëtare në fuqi, janë shumë parametra hapësinorë, organizativë dhe të pajisjes, të cilët e kualifikojnë një hapësirë tualeti si të qasshme/shfrytëzueshme nga PAK. Bazuar në të dhënat e vlerësimit, pothuajse asnjëra nga shkollat nuk i ka tualetet që i përmbushin të gjitha parametrat e qasshmërisë.

Por ekzistojnë shkolla që kanë adaptuar (në rastet e shkollave të vjetra) apo i kanë të ndërtuara kthinat për shfrytëzim nga ana e PAK. Në shumicën e rasteve, përmasat e kthinave dhe pajimi janë të mangëta, si dhe në shumicën e rasteve, këto kthina janë të bllokuara, të kyçura nga personeli i mirëmbajtjes apo mësimdhënës dhe shfrytëzohen si depo apo si tualete të personelit. Kjo është një barrierë e krijuar nga keqmenaxhimi i shkollës.

Pjesa më e madhe e shkollave urbane janë disa katëshe, dhe përpos ndonjë rasti të izoluar kur për kapërcimin e kateve ekziston ashensori (jo funksional) apo platforma ngritëse (vetëm një rast), asnjë nga shkollat nuk kanë mundësi të organizojnë mësim për nxënës me aftësi të kufizuara fizike në katet e sipërme. Ndërsa situata për shfrytëzueshmërinë e ndërtesave nga persona me aftësi të kufizuara pamore, qoftë të verbër apo me kapacitete të ulëta pamore, është më kritikja. E gjithë infrastruktura shkollore e vlerësuar është jomiqësore për shfrytëzim dhe lëvizje nga ana e personave të verbër. Ndërsa raste të izoluar kanë shkallët e brendshme me basamakë të punuara me ngjyra të ndryshme (siç specifikohet me normat dhe standardet e MASH për ndërtesa shkollore), por jo edhe sipas U. A. 33/2007 dhe standardeve ndërkombëtare, me basamakë me shirita kontrastues, që ndihmojnë lëvizjen e nxënësve me probleme pamore.

Situata e paraqitur në këtë hulumtim që ilustron praninë e barrierave të panumërta arkitektonike në ndërtesat shkollore të vlerësuara dëshmon angazhimin e pamjaftueshëm të institucioneve lokale dhe qendrore drejt krijimit të mundësive të qasjes fizike për PAK, në ndërtesa të arsimit të ulët dhe mesëm ulët, si parakusht për integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsim. Prandaj, ky raport duhet të sinjalizojë nivelet e ndryshme të administrimit të arsimit parauniversitar në Kosovë, se është koha e fundit që të ndërmerren masa për eliminimin e barrierave që pengojnë integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, e rrjedhimisht integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë kosovare.

REKOMANDIMET

Nga të gjeturat e përshkruara sipër, lidhur me nivelin e qasjes që shkollat në Kosovë ofrojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara, rekomandimet janë të targetuara në tri pjesë të cilat vlerësohet të kenë impakt të rëndësishëm në avancimin e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend, e gjithashtu edhe rekomandimet teknike të dala nga hulumtimi e të cilat i kontribuojnë kauzës.

Rekomandime për nivelin qendror

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit të mbledh një grup punues të përbërë nga akterë kryesorë të fushës së ndërtimit, zyrtarë administrativë nga nivelet e ndryshme qeverisëse, përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar, qytetarë me aftësi të kufizuara, të moshuar, etj., dhe të hartojë dhe ta procedojë në Kuvend për votim një ligj për ndërtimin dhe shfrytëzimin universal të ndërtesave, ku do të integroheshin kërkesat themelore nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për mundësimin e qasjes në ndërtesa dhe parimet e dizajnit universal, si dhe standardet ndërkombëtare në fuqi për qasje dhe praktika të mira nga shtetet e BE-së.

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ta rishikojë Ligjin për Ndërtimin dhe të shtojë dispozita për eliminimin e barrierave arkitektonike në mjedisin e ndërtuar.

- Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të ligjeve vjetore të buxhetit shtetëror, të caktojë një zë të veçantë në kuadër të buxhetit për përmirësimet infrastrukturore, që do ta adresonte eliminimin e barrierave arkitektonike.

- Ministria e Arsimit, në kohë sa më të shkurtër, përmes një grupi punues gjithëpërfshirës, ku akterë të rëndësishëm të përfaqësuar do të jenë personat me aftësi të kufizuara, të krijojë një strategji dhe plan veprimi për eliminimin e barrierave arkitektonike në ndërtesat shkollore. Në ndërlidhje me këtë strategji, të ndahen pjesë nga buxheti vjetor i Ministrisë i dedikuar për infrastrukturë, që do të përdoret për përshtatjen e shkollave për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me dikasteret përkatëse të komunave, duhet të ndërtojë mekanizma për zbatimin e Udhëzuesit për Projektimin e Ndërtesave Shkollore (vëll. 1 dhe vëll.2)[10], gjatë procesit të projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave shkollore. Këto dy udhëzime i referohen U. A. 33/2007, si dhe i japin në mënyrë shumë të qartë standardet për akomodimin e kërkesave hapësinore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në ndërtesat arsimore.



Rekomandime për shoqërinë civile

- Vazhdimi i avokimit për të drejtat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara për qasje në arsim dhe me këtë edhe përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës fizike të shkollave.
- Vazhdimi i avokimit qytetar ndaj institucioneve qendrore dhe lokale për të siguruar zbatimin e rregulloreve dhe kuadrit ligjor në përgjithësi, që mundëson integrimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.
- Fasilitasi dhe ndërmjetësimi i komunikimit ndërmjet pushtetit lokal dhe komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në lidhje me nevojat dhe problemet e qasjes në mjedis të ndërtuar.

Rekomandime për nivelin lokal

- Formimi i komisioneve të përbëra nga profesionistë dhe përfaqësues të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara për evidentimin e barrierave arkitektonike në shkolla dhe dhënien e zgjidhjeve për eliminimin e tyre.
- Hartimi i një instrumenti vlerësues, i cili do të përmbante zgjidhjet dhe kostot e intervenimeve përmirësuese që kanë për qëllim largimin e barrierave arkitektonike në ndërtesat shkollore.
- Inkuadrimi i përfaqësuesve të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në komisione vlerësuese të projekteve, komisione të pranimeve teknike për projektet e ndërtesave shkollore, për të siguruar përfaqësimin e interesave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara dhe zbatimin e rregulloreve teknike për qasje fizike të papenguar dhe lëvizje të lirë në këto ndërtesa.



Rekomandime teknike të dala nga hulumtimi

- Rekomandohet që për çdo shkollë të parashihen parkingje për persona me aftësi të kufizuara ashtu siç parashihen me U. A. 33/2007. Sipas këtij udhëzuesi, 5% të vendparkimeve të përgjithshme parashihen të jenë parkingje për PAK, por jo më pak se një vendparkim [11]. Përmasat e këtyre vendparkimeve duhet të jenë 370 X 500 cm [12]. Rekomandohet që këto parkingje të vendosen sa më afër hyrjes së ndërtesës. Pos përcaktimit të vendeve për parkim për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, ato duhet të shenjëzohen me shenja qasëse. Komuna në bashkëpunim me policinë duhet të zbatojnë penalizime ndaj makinave të tjera, të cilat bllokojnë, apo parkojnë mbi vendet e shënuara për shfrytëzim ekskluziv prej komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.

- Rekomandohet që të gjitha hyrjet në ndërtesat e shkollave të bëhen të qasshme për persona me aftësi të kufizuara përmes rampave ose platforma ngritëse (varësisht prej lartësisë së hyrjes nga niveli i terrenit). Rampat të punohen sipas kushteve që parashihen në dispozitat e U. A. 33/2007. Në rastet e rampave ekzistuese, që rezultojnë të paqasshme për shkak të pjerrtësisë së madhe, ose për shkak të mungesës së mbajtëseve, a ndonjë parametri tjetër, rekomandohet përmirësimi i këtyre parametrave në përputhshmëri me standardet.

- Rekomandohet që në ndërtesa shkollore, përgjatë shkallëve të hyrjeve dhe atyre të brendshme të parashihen mbajtëse të projektuara në përmasa dhe formë që do të lehtësonin komunikimin nëpër shkallë për persona që kanë vështirësi të lëvizjes në këmbë. Mbajtëset/anësoret e shkallëve duhet të jetë në dy lartësi, në mënyrë që t'ua lehtësojnë personave me gjatësi të ndryshme që të ngjiten shkallëve pa problem.

- Rekomandohet që të shkollat e mëdha, që kanë hapësirë të përshtatshme, të instalohen ashensorë sipas përshkrimeve në dispozitat e U. A. 33/2007. Në pamundësi të këtij intervenimi, të planifikohet instalimi i platformës palosëse.

- Rekomandohet që në shkolla që nuk kanë tualete për persona me aftësi të kufizuara, t'i organizojnë ato brenda grupit të tualeteve ekzistuese, apo në ndonjë hapësirë të përshtatshme. Tualetet duhet të jenë të përmasave që të akomodojnë përdorues karrocash (shih nenin 18 të UA 33/2007), dhe të pajisen me pajisjet sanitare standarde. Në disa raste, shkollat e evidentuara në hulumtim, kishin tualetet për persona me aftësi të kufizuara që nuk ishin të pajisura në mënyrë complete, ose përdoren si depo materiali. Përmes inspeksioneve komunale, ose mekanizmave të tjerë komunalë, duhet të ndalohen këto praktika të cilat infrastrukturën ekzistuese për persona me aftësi të kufizuar e bëjnë të paqasshme.

- Rekomandohet vendosja e domosdoshme e shenjave qasëse (neni 4. 10) për shënjimin e elementeve të obliguara për qasje (rampat, parkingjet, tualetet, ndërtesat që kanë elementet qasëse, ashensorët, etj.).

- Rekomandohet vendosja e planit orientues tek hyrjet e ndërtesave publike, për të ndihmuar lëvizjen dhe orientimin në ndërtesë të personave të verbër. Në nenin 35 të U. A. 33/2007 përcaktohen përmasat dhe mënyra se si punohet pllaka e planit.

- Rekomandohet vendosja e vijave drejtuese dhe paralajmëruese taktore si dhe fushave taktore para hyrjeve (shkallëve hyrëse), ashensorëve, vendeve ku ndërrohen nivelet, sporteleve të qasshme, ashtu siç parashihen të realizohen në U. A. 33/2007 për të promovuar lëvizjen e pavarur të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar. Rekomandohet që këto elemente qasëse për lëvizjen e personave të verbër të realizohen me një ngjyrë që krijon kontrast pamor ndaj veshjes kryesore të shkallëve. Për t'ua lehtësuar ngjitjen/zbritjen në shkallë personave me shikim të dobësuar, rekomandohet vendosja e shiritave me gjerësi minimum 2 cm, në secilën shkelëse të shkallëve. Këto shirita përpunohen nga material jo rrëshqitës, si dhe me ngjyrë që krijon kontrast shkëlqimi me diferencë prej 70% në raport me sipërfaqen e dyshemesë.

SHTOJCA 1**Lista e shkollave të vlerësuara**

Nr.	Emri i shkollës	Komuna
1	SHFMU "Gjon Serreçi"	Ferizaj
2	SHFMU "Jeronim de Rada"	Ferizaj
3	SHFMU "Ahmet Hoxha"	Ferizaj
4	SHFMU "Tefik Çanga"	Ferizaj
5	SHFMU "Vezir Jashari"	Ferizaj
6	SHFMU "Astrit Bytyçi"	Ferizaj
7	SHFMU "Ganimete Tërbeshi"	Ferizaj
8	SHFMU "Besim Rexhepi"	Ferizaj
9	SHFMU "Emin Duraku" – cikli i ulët	Kaçanik
10	SHFMU "Emin Duraku" – cikli i lartë	Kaçanik
11	SHFMU "Idriz Seferi"	Bob, Kaçanik
12	SHFMU "Jusuf Gërvalla"	Gajre, Kaçanik
13	SHFMU "Idriz Seferi"	Gajre, Kaçanik
14	SHFMU "Jusuf Gërvalla"	Nikë, Kaçanik
15	SHFMU "Idriz Seferi"	Trimor, Kaçanik
16	SHFMU "Qamil Ilazi"	Kaçanik i vjetër
17	SHFMU "Staja Markovic"	Shtërpce
18	SHFMU "Emin Duraku"	Shtime
19	SHFMU "Ilaz Thaçi"	Hani i Elezit
20	SHFMU "Kështjella e diturisë"	Paldenicë, Hani i Elezit
21	SHFMU "Abaz Ajeti"	Gjilan
22	SHFMU "Thimi Mitko"	Gjilan
23	SHFMU "Selami Hallaqi"	Gjilan
24	SHFMU "Sadulla Brestovci"	Gjilan
25	SHFMU "Nazim Hikmet"	Dobërçan, Gjilan
26	SHFMU "Rexhep Elmazi"	Dheu i Bardhë, Gjilan
27	SHFMU "Mulla Idriz Gjilani"	Velekincë, Gjilan
28	SHFMU "Besim Rexhepi"	Livoç i Poshtëm, Gjilan
29	SHFMU "Vatra e diturisë"	Livoç i Epërm, Gjilan
30	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"	L. Malësia, Kamenicë
31	SHFMU "Fan Stilian Noli"	Kamenicë
32	SHFMU "Hasan Prishtina"	Busavatë, Kamenicë
33	SHFMU "Avdullah Krashnica"	Koretin, Kamenicë
34	SHFMU "Rexhep Mala"	Topanicë, Kamenicë
35	SHFMU "Bafti Haxhiu"	Viti
36	SHFMU "Dëshmorët e Vitisë"	Viti
37	SHFMU "Nazmi Pajaziti"	Radivojc, Viti
38	SHFMU "Emin Duraku"	Prizren
39	SHFMU "Fatmir Berisha"	L. Bajram Curri, Prizren
40	SHFMU "Fadil Hisari"	Prizren
41	SHFMU "Mustafa Bakui"	Prizren
42	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Prizren
43	SHFMU "Mati Logoreci"	Prizren
44	SHFMU "Motrat Qiriazit"	Prizren
45	SHFMU "Lekë Dukagjini"	Prizren
46	SHFMU "Ibrahim Fehmiu"	L. Arbanë, Prizren
47	SHFMU "Abdyl Frashëri" ndërtesa 1	Prizren
48	SHFMU "Abdyl Frashëri" ndërtesa 2	Prizren
49	SHFMU "Dëshmorët e Zhurit"	Zhur, Prizren
50	SHFMU "Besim Ndrecaj"	Lutogllavë, Prizren

Nr.	Emri i shkollës	Komuna
51	SHFMU "7 marsi"	Suharekë
52	SHFMU "Shkëndija"	Suharekë
53	SHFMU "Destan Bajraktari"	Suharekë
54	SHFMU "Migjeni"	Gjinoc, Suharekë
55	SHFMU "17 shkurti"	Shirokë, Suharekë
56	SHFMU "Sadri Duhla"	Duhël, Suharekë
57	SHFMU "Fetah Sylejmani" Cikli i U.	Dragash
58	SHFMU "Fetah Sylejmani" Cikli i L.	Dragash
59	SHFMU "Anadolu"	Mamushë
60	SHFMU "Zekerja Rexha"	Gjakovë
61	SHFMU "Emin Duraku"	Gjakovë
62	SHFMU "Fehmi Agani"	Gjakovë
63	SHFMU "Mustafa Bakija"	Gjakovë
64	SHFMU "Kelmend Rizvanolli"	Gjakovë
65	SHFMU "Mazllom Këpuska"	Gjakovë
66	SHFMU "Yll Morina"	Gjakovë
67	SHFMU "Ardhmëria"	Ramoc, Gjakovë
68	SHFMU "Dy dëshmorët"	Sheremet, Gjakovë
69	SHFMU "Ganimete Tërbeshi"	Ponoshec, Gjakovë
70	SHFMU "Luigj Gurakuqi"	Korenicë, Gjakovë
71	SHFMU "Zef Lush Marku"	Mejë, Gjakovë
72	SHFMU "Bekim Sylka"	Rahovec
73	SHFMU "Isa Boletini"	Rahovec
74	SHFMU "Gëzim Hamza - Piktori"	Rahovec
75	SHFMU "Ibrahim Mazreku"	Malishevë
76	SHFMU "Emin Duraku"	Dragobil, Malishevë
77	SHFMU "Ganimete Tërbeshi"	Astrazup, Malishevë
78	SHFMU "Edmond Hoxha"	Junik
79	SHFMU "Jahë Salihu"	Molliq, Junik
80	SHFMU "Dardania"	Pejë
81	SHFMU "Ramiz Sadiku"	Pejë
82	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Pejë
83	SHFMU "28 Nëntori"	Raushiq, Pejë
84	SHFMU "7 shtatori"	Vitomiricë, Pejë
85	SHFMU "28 nëntori"	Lybeniq, Pejë
86	SHFMU "Bajram Curri"	Istog
87	SHFMU "Avni Rustemi"	Zallq, Istog
88	SHFMU "Hysni Zajmi"	Vrellë, Istog
89	SHFMU "Trepça"	Bajë e Pejës, Istog
90	SHFMU "Martin Camaj"	Gurakoc, Istog
91	SHFMU "Ismet Rraci"	Klinë
92	SHFMU "Motrat Qiriazit"	Klinë
93	SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi"	Zllakuqan, Klinë
94	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Deçan
95	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"	Strelc i U. Deçan
96	SHFMU "Bajram Curri"	Strelc i E. Deçan
97	SHFMU "Verrat e Llukës"	Llukë, Deçan
98	SHFMU "Sylejman Vokshi"	Prejlep, Deçan
99	SHFMU "Isa Boletini"	Isniq, Deçan
100	SHFMU "Abdullah Shabani"	Mitrovicë
101	SHFMU "Andon Zako Çajupi"	Mitrovicë
102	SHFMU "Abdullah Shabani"	Mitrovicë
103	SHFMU "Eqrem Çabej"	Mitrovicë
104	SHFMU "Ismail Qemali"	Mitrovicë
105	SHFMU "Migjeni"	Mitrovicë
106	SHFMU "Musa Hoti"	Mitrovicë

Nr.	Emri i shkollës	Komuna
107	SHFMU "Nonda Bulka"	Mitrovicë
108	SHFMU "Bislim Imeri"	Kuç i M. Mitrovicë
109	SHFMU "Enver Hadri"	Kuç i V. Mitrovicë
110	SHFMU "Skënderbeu"	Shipol, Mitrovicë
111	SHFMU "Andon Zako Çajupi"	Vushtrri
112	SHFMU "Mustafë Venhari"	Vushtrri
113	SHFMU "Naim Frashëri"	Vushtrri
114	SHFMU "SHMU2"	Vushtrri
115	SHFMU "Ahmet Delija"	Skënderaj
116	SHFMU "Shaban Jashari"	Skënderaj
117	SHFMU "Idriz Barani"	Klinë e E. Skënderaj
118	SHFMU "Azem Bejta"	Prekaz i E. Skënderaj
119	SHFMU "Faik Konica"	Prishtinë
120	SHFMU "Hasan Prishtina"	Prishtinë
121	SHFMU "Xhemal Mustafa"	Prishtinë
122	SHFMU "Dardania"	Prishtinë
123	SHFMU "Naim Frashëri"	Prishtinë
124	SHFMU "Meto Bajraktari"	Prishtinë
125	SHFMU "Andon Zako Çajupi"	Bardhosh, Prishtinë
126	SHFMU "Nexhmi Mustafa" 1	Besi, Prishtinë
127	SHFMU "Nexhmi Mustafa" 1	Besi, Prishtinë
128	SHFMU "Nëna Tereze"	Vranidoll, Prishtinë
129	SHFMU "Ganimete Tërbeshi"	Llukar, Prishtinë
130	SHFMU "Teuta"	Grashticë, Prishtinë
131	SHFMU "Mitrush Kuteli"	Matiçan, Prishtinë
132	SHFMU "Afrim Gashi"	Hajvali, Prishtinë
133	SHFMU "Dëshmorët e 1921"	Prapashticë, Prishtinë
134	SHFMU "Rilindja"	Keqekollë, Prishtinë
135	SHFMU "Xheladin Rekalu"	Podujevë
136	SHFMU "Zenel Hajdini"	Lupç i Poshtëm, Podujevë
137	SHFMU "Afrim e Fahriu"	Lluzhan, Podujevë
138	SHFMU "Daut Bogujevci"	Fushë Kosovë
139	SHFMU "Ibrahim Rugova"	Obiliq
140	SHFMU "Halil Bajraktari"	Drenas
141	SHFMU "Gjergj Fishta"	Lipjan
142	SHFMU "Minatori"	Koloni e re, Novobërdë
143	SHFMU "Hanumshahe e Tefik Z"	Pasjak, Novobërdë
144	SHFMU "Asdreni"	Llabjan, Novobërdë

SHTOJCA 2

Lista e hulumtuesve të terrenit

Emri & Mbiemri	Profesioni	Regjioni i mbuluar
Eljesa Bela	Student i arkitekturës	Ferizaj
Nita Hasimja	Student i arkitekturës	Gjakovë
Arba Shushka	Student i arkitekturës	Prishtinë
Diellza Breznica	Student i arkitekturës	Mitrovicë
Alberitë Hylaj	Punëtore sociale	Pejë
Rigon Çollaku	Student i arkitekturës	Prizren
Lindon Mustafa	Student i arkitekturës	Gjilan



SHTOJCA 3

Fotografi të rasteve ideale të qasjes në shkollë

Më poshtë janë ilustruar fotografi të cilat pasqyrojnë rastet ideale të qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollë, sipas parametrave të cilët janë konsideruar gjatë vlerësimit në këtë hulumtim.



Shkollë fillore në Sasebo, Japoni, nga HIBINOSEKKEI, Kids Design Labo, Youji no Shiro, 2019. Foto: T. Suga. Burimi: <https://www.archdaily.com/924188/kb-primary-and-secondary-school-hibinosekkei-plus-youji-no-shiro-plus-kids-design-labo?ad> (qasur më, 17.02.2020)




Shkolla Margarete Steiff, Stuttgart, OHO Architekten GbR, 2017. Burimi: <https://www.dormakaba.com/cn-en/knowledge-center/success-stories/margarete-steiff-school---stuttgart--ger--423504> (qasur më, 17.02.2020)




Enabling Village- Qendër Komuniteti në Singapur, nga WOHA. Foto: E. Hendricks, Burimi: <https://www.archdaily.com/801850/enabling-village-woha/5858aba0e58ecef57000848-enabling-village-woha-photo> (qasur më, 17.02.2020)



Skica e organizimit dhe dimensionimit të tualetit të qasshëm për persona me aftësi të kufizuara, sipas kriterëve të U. A. 33/2007. Burim: Udhëzimi Administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më, 17.02.2020)




Ashensori i qasshëm për persona me aftësi të kufizuara sipas U. A. 33/2007. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më, 02.04.2020)



Shembull i planit të orientimit për lëvizje në një ndërtesë. Burimi: <http://www.deltaceramica.it/mappe.html> (qasur më, 02.04.2020)




Fig. 7. Shiritat kontrastues në shkallë të jashtme në shkollën në Orewa, Zelandë e re. Burimi: <https://www.totaltactile.co.nz/projects/orewa-primary-school/> (qasur më, 17.02.2020)



Shkallët e brendshme me shiritat kontrastues dhe me mbajtëse të përshtatshme për fëmijë të vegjël. Shkolla Exupery International School në Pinki, Letoni. Projekti: 8 A.M. Viti. 2016. Foto: I. Sturmanis. Burimi: <https://www.archdaily.com/803016/exupery-international-s> (qasur më, 17.02.2020)



Shenjat e qasjes për PAK sipas U. A. 33/2007. Burimi:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më,
 02.04.2020)



Organizimi i klasave të qasshme për PAK sipas U. A. 33/2007.
 Burimi U. A. 33/2007, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më, 02.04.2020)

SHTOJCA 4

Fotografi të problematikave të identifikuara në terren

Më poshtë janë të paraqitura fotografi të problematikave më të shpeshta të hasura përgjatë vlerësimeve në terren:







Toaleti për PAK shfrytëzohet si depo



Hyrja në shkollë në nivel me terrenin, por brenda ndërtesës paraqiten shkallë. Nuk ka elemente qasëse



Nuk ka fare rampë



Hyrja e shkollës nuk ka fare rampë qasëse



Hapësira me disnível e pa elemente qasëse

SHTOJCA 5

Literatura

- [1] Disabili.com, Barriere Architettoniche e Accessibilita, <https://www.disabili.com/mobilita-auto/speciali-mobilita-a-auto/barriere-architettoniche-e-disabilita>, (qasur më, 28.01.2020).
- [2] Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, United Nation Convention on the Rights of Persons With Disability, Kombet e Bashkuara, New York, 2006, (qasur më, 06.04.2020).
- [3] Casserley C., Ormerod M., në Clarckson J., Coleman R., Keates S., Lebbon C., (eds.), Inclusive Design: Design for the Whole Population, Springer Verlage Ltd, London, 2003, fq. 142 -154.
- [4] Titchkosky T., The Question of Access: Disability, Space, Meaning, University of Toronto Press, 2011.
- [5] Basha R., Hapësira publike për të gjithë, rastet studimore Prishtinë dhe Prizren, tezë doktrature, UPT, Tiranë, 2019, publikim online, <http://upt.al/artikuj-shkencore/1063-fau-hapesirat-publike-per-te-gjithe-rastet-studimore-prishtine-dhe-prizren>, (qasur më, 06.04.2020).
- [6] Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Convention on the Rights of Child, Kombet e Bashkuara, New York 1989.
- [7] General Assembly of United Nations, 2030 Agenda for Sustainable Development, Rezoluta e adoptuar nga Këshilli i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, New York, 25 shtator 2015, <https://undocs.org/A/RES/71/313>, (qasur më, 02.02.2020).
- [8] Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>, (qasur më, 02.02.2020).
- [9] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2016/2017, <https://ask.rks-gov.net/media/3439/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-shqip.pdf> (qasur më, 22.01.2020).
- [10] MASH, Udhëzues për norma dhe standard për ndërtesa shkollore, Vëll. 1 dhe Vëll. 2, 2015, <https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-norma-dhe-standardet-e-ndertesave-shkollore>, (qasur më, 03.02.2020).
- [11] Neni 50, pika (1) e U. A. 33/2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më 15.09.2016)
- [12] Neni 38, U. A. 33/2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7480> (qasur më 15.09.2016).

